NDIHMA JURIDIKE • PRAVNA POMOĆ
LEGAL AID

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada-Government

Ministria e Drejtësisë-Ministarstvo Pravde-Ministry of Justice

Agjencia për Ndihmë Juridike Falas-Agencija za Besplatnu Pravnu Pomoć
Agency for Free Legal Aid

ANALIZË E PËRMBAJTJES DHE ZBATIMIT PRAKTIK TË LIGJIT PËR NDIHMË JURIDIKE FALAS

24 & 25 Maj 2023

Prishtinë, 2023

PËRMBAJTJA

SHKURTESAT **3**

I. HYRJE **4**

1.1. HISTORIKU I FUNKSIONIMIT DHE KONTEKSTI I PUNËS SË AGJENCISË PËR NDIHMË JURIDIKE FALAS NË KOSOVË

II. QËLLIMI I ANALIZËS DHE METODOLOGJIA .... ERROR! BOOKMARK NOT DEFINED.**5**

III. ANALIZË E LEGJISLACIONIT DHE TË GJETURAT MBI SFIDAT LIGJORE TË FUSHËS SË NDIHMËS JURIDIKE FALAS NË KOSOVË **6**

3.1. Korniza legjislative për ndihmë juridike falas **6**

3.2. Gjendja aktuale dhe hapat reformues të ANJF-së në aspektin ligjor Error! Bookmark not defined. **9**

3.3 Nevoja për ndryshime dhe plotësime të kornizës ligjore për ndihmë juridike falas .....Error! Bookmark not defined.

IV. REKOMANDIME **18**

4.1 Shtrirja e Ndihmës Juridike Falas në tërë territorin e Republikës së Kosovës **18**

4.2 Unifikimi i ndihmës juridike falas në Kosovë **19**

4.3 Struktura dhe fuqizimi i Agjencisë **19**

4.4 Buxheti i pamjaftueshëm **21**

4.5 Kriteret për të qenë përfitues i ndihmës juridike falas dhe kategoritë e veçanta Error! Bookmark not defined..... **21**

4.6 Mënyra e përfaqësimit **21**

4.7 Shpenzimet e procedurës **21**

4.8 Rimbursimi i shpenzimeve **21**

4.9 Përfaqësimi nga zyrtarët deri në vlerën e revizionit **21**

4.10 Klinikat ligjore **22**

4.11 Racionalizimi 22

SHKURTESAT

ANJF	Agjencia për Ndihmë Juridike Falas
ZRNJF	Zyra Rajonale për Ndihmë Juridike Falas
ZMNJF	Zyra Mobile për Ndihmë Juridike Falas
LNJF	Ligji për Ndihmë Juridike Falas
MD	Ministria e Drejtësisë
OAK	Oda e Avokatëve të Kosovës
GIZ	Deutsche Gesellschaft fuer Internationale Zusammenarbeit
USAID	The United States Agency for International Development
UNDP	United Nations Development Programme

HYRJE

1.1 HISTORIKU I FUNKSIONIMIT DHE KONTEKSTI I PUNËS SË AGJENCISË PËR NDIHMË JURIDIKE FALAS NË KOSOVË

Shtetet kanë obligim ndërkombëtar që nëpërmjet institucionit të Ndihmës Juridike Falas të garantojnë qasje në drejtësi për të gjithë personat në nevojë, bazuar në kriteret e paravendosura që ndërlidhen me pamundësinë financiare të sigurimit të Ndihmës Juridike. Sipas "*Konventes Evropiane për të Drejtat e Njeriut", neni 6 (3) (c), e drejta në ndihmë juridike falas është e garantuar në rastet kur i akuzuari nuk ka mjete të mjaftueshme për të paguar për Ndihmë Juridike dhe në rastet kur interesi i drejtësisë këtë e kërkon*. Në të njëjtën mënyrë, edhe *neni 47 i "Kartës së të Drejtave Fundamentale të Bashkimit Evropian"*, përcakton se Ndihma Juridike ofrohet për ata që u mungojnë mjetet e mjaftueshme, dhe për aq sa ajo ndihmë është nevojshme për të siguruar qasje efektive në drejtësi.

Korniza ligjore për funksionimin e Agjencisë për Ndihmë Juridike Falas – (tutje ANJF) është Kushtetuta e Republikës së Kosovës, më konkretisht, *neni 31 paragrafi 6 definon* se "Ndihma Juridike Falas do t'u mundësohet atyre që nuk kanë mjete të mjaftueshme financiare, nëse një ndihmë e tillë është e domosdoshme, për të siguruar qasje efektive në drejtësi".

Ndihma Juridike Falas në Kosovë fillimisht është ofruar nga Agjencia Evropiane për Rindërtim prej vitit 2001-2005, nëpërmjet projektit "Ndihma Juridike Falas në çështje Civile dhe Administrative", e zbatuar nga Oda e Avokatëve të Kosovës dhe e realizuar nga OJQ-të vendore. Pas përfundimit të projektit, nga raportet e paraqitura është konstatuar se pjesa dërmuese e popullsisë së Kosovës përmbush kriteret për të përfituar nga shërbimet e ofrimit të Ndihmës Juridike Falas.

Për këtë arsye Agjencia Evropiane për Rindërtim financoi edhe projektin "Krijimi i sistemit gjithëpërfshirës të Ndihmës Juridike Falas në Kosovë", i realizuar nga Agjencia Gjermane - Instituti ICON. Realizimi i projektit luajti rol të rëndësishëm në institucionalizimin e Ndihmës Juridike në vendin tonë.

Në vitin 2006 është themeluar Komisioni për Ndihmë Juridike (KNJ), i cili ka vepruar në bazë të *Rregullores së UNMIK-ut 2006/36* për Ndihmë Juridike, kurse në vitin 2012, në pajtim me *Ligjin nr.04/L-017 për Ndihmë Juridike Falas* është themeluar Agjencia për Ndihmë Juridike Falas (tutje ANJF).

Ligji bazik nr. 04/L-017 për Ndihmë Juridike Falas rregullon krijimin e një sistemi funksional për Ndihmë Juridike Falas në procedurën Civile, Penale, Administrative dhe Kundërvajtëse. Nëpërmjet këtij ligji është siguruar qasja efektive në drejtësi për qytetarët të cilët nuk kanë mjete të mjaftueshme financiare.

Gjatë vitit 2022 janë bërë ndryshime ligjore në palët përfituese të ndihmës juridike falas si dhe së fundi edhe në funksionimin e Agjencisë për Ndihmë Juridike Falas. Në Mars të vitit 2022 ka hyrë në fuqi Ligji Nr. 08/L-035 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-017 për Ndihmë Juridike Falas i cili ka përfshirë kategoritë e veçanta përfituese të ndihmës juridike falas, si dhe në Shtator të vitit 2022 ka hyrë në fuqi Ligji Nr. 08/L-063 - për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjeve që kanë të bëjnë me Racionalizimin dhe Vendosjen e Vijave Llogaridhënëse të Agjencive të Pavarura.

Konform Ligjit Nr. 08/L-063 - për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjeve që kanë të bëjnë me Racionalizimin dhe Vendosjen e Vijave Llogaridhënëse të Agjencive të Pavarura, Agjencia për Ndihmë Juridike Falas tashmë është Agjenci Ekzekutive në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë, e vetmja në Republikën e Kosovës, përgjegjëse për organizimin dhe ofrimin e Ndihmës Juridike Falas.

Këto ligje rregullojnë krijimin e një sistemi funksional për Ndihmë Juridike Falas në procedurën Civile, Penale, Administrative dhe Kundërvajtëse, nëpërmjet të cilit sigurohet qasja efektive në drejtësi për qytetarët të cilët nuk kanë mjete të mjaftueshme financiare. ANJF është institucioni më i rëndësishëm në sistemin e integruar të Ndihmës Juridike në drejtim të ofrimit të Ndihmës Juridike Falas. Numri dhe llojllojshmëria e kërkesave të shfrytëzuesve të Ndihmës Juridike tregojnë nevojën dhe rëndësinë e qëndrueshmërisë së këtij institucioni.

ANJF ka për **Vizion** që personat në nevojë dhe grupet e margjinalizuara në Republikën e Kosovës të kenë qasje të barabartë në drejtësi dhe t'u ofrohet Ndihma Juridike Falas cilësore nga ANJF-ja dhe partnerët e saj mbështetës dhe **Misioni** i saj është përkushtimi i ofrimit të Ndihmës Juridike Falas duke siguruar qasje të barabartë në drejtësi për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës.

QËLLIMI I ANALIZËS DHE METODOLOGJIA

Duke u mbështetur në përvojat e së kaluarës qëllimi i kësaj analize është të identifikojë dhe nxjerrë në pah sfidat kryesore të Agjencisë për Ndihmë Juridike Falas, në aspektin ligjor, institucional dhe funksional, të prezantojë sfidat dhe zgjidhjet përkatëse për një ristrukturim të duhur të sistemit të ofrimit të ndihmës juridike falas në Kosovë. Që nga Shatori 2022, përgjegjësitë për hartimin e politikave, standardeve dhe inspektimin e shërbimeve të ndihmës juridike falas janë transferuar në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë (MD). Për të zbatuar në mënyrën më të mirë të mundshme reformën e ofrimit të shërbimeve të ndihmës juridike falas dhe për të adresuar nevojat e qytetarëve, kjo analizë do të shërbejë si bazë për reformimin e ANJF-së në aspektin ligjor, institucional dhe funksional.

Qëllimi i Agjencisë është që përmes kësaj analize të lehtësoj punën e hartimit të koncept dokumentit dhe avancimin e sistemit të ndihmës juridike falas.

• Politikat e shtrirjes së ndihmës juridike falas në tërë territorin e R. Kosovës

• Unifikimin e ndihmës juridike falas në Kosovë; dhe

• Fuqizimin e Agjencisë dhe ngritja e kapaciteteve njerëzore dhe profesionale;

Metodologjia që është zbatuar përgjatë kësaj analize paraqet një qasje të kombinuar të hulumtimit sasior dhe cilësor me qëllim të mbledhjes së të dhënave mbi funksionimin aktual strukturor të ANJF-së, sfidat me të cilat ballafaqohen në aspektin e rregullimit ligjor dhe të realizimit në praktikë të detyrimeve që ka shteti për sigurimin e qasjes në drejtësi për të gjithë qytetarët të cilat nuk kanë mjete të mjaftueshme financiare për të realizuar të drejtat e tyre ligjore. Analiza është mbështetur në mbledhjen e të dhënave nga këto burime:

- Kornizën ligjore aktuale, si dhe dokumentet, analizat dhe raportet e institucioneve të ndryshme, e që kanë pasur për bazë studimin e sfidave të ANJF-së;
- Raportet relevante nga raportimet periodike të Zyrave Rajonale dhe Mobile për Ndihmë Juridike Falas të ANJF-së;
- Studimet empirike të kryera më herët nga institucionet kredibile mbi gjendjen dhe kapacitetet e shërbimeve të ndihmës juridike falas në Kosovë.
- Përpunimi statistikor dhe kryqëzimi i të dhënave për numrin e përgjithshëm të personave të cilëve u është ofruar ndihma juridike falas;
- Vlerësimi i kritereve për përfituesit e NJF etj.

Pas analizës së të dhënave është diskutuar me grupin punues nga radhët e stafit të ANJF-së i themeluar për zhvillim të analizës në një punëtori dy ditore dhe është plotësuar tutje sipas imputeve nga anëtarët e grupit punues.

ANALIZË E LEGJISLACIONIT DHE TË GJETURAT MBI SFIDAT LIGJORE TË FUSHËS SË NDIHMËS JURIDIKE FALAS NË KOSOVË

Korniza legjislative për ndihmë juridike falas

Sistemi i ndihmës juridike falas, bazohet në Kushtetutë dhe në Konventat dhe instrumentet ndërkombëtare, disa prej të cilave që janë të numëruara taksativisht në

bazë të nenit 22 të Kushtetutës, të cilat zbatohen drejtpërdrejtë në Kosovë dhe kanë epërsi mbi ligjet. Për sa i takon Konventave dhe instrumenteve tjera ndërkombëtare që nuk janë të zbatuara drejtpërdrejt në Kosovë, me rastin e hartimit të ligjeve, legjislacioni i Kosovës gjithmonë hartohet në pajtim me parimet e përgjithshme të tyre, për aq sa ka mundësi që ato të gjejnë zbatim në Kosovë. Disa nga Konventat dhe instrumentet ndërkombëtare, si dhe disa nga ligjet më të rëndësishme që rregullojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë fushën e ndihmës juridike falas janë me sa vijon:

- **Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut**
- **Karta e të Drejtave Fondamentale të Bashkimit Evropian**
- **Kushtetuta e Republikës së Kosovës miratuar nga Kuvendi i Kosovës 15.06.2008**
- **Ligji nr.04/L-017 për Ndihmë Juridike Falas / Ligji Nr. 08/L-035 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-017 për Ndihmë Juridike Falas / Ligji Nr. 08/L-063 - për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjeve që kanë të bëjnë me Racionalizimin dhe Vendosjen e Vijave Llogaridhënëse të Agjencive të Pavarura**
- **Kodi Penal i Kosovës, 06/L-074, datë 14.01.2019.**
- **Kodi i Procedurës Penale, nr. 04/L-123, datë 28.12.2012, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 06/L-091 datë 04.07.2019 dhe ligjin nr.08/L-002, datë 18.06.2021.**
- **Kodi i Drejtësisë për të Mitur nr. 03-L193, datë 20.08. 2010.**
- **Ligji për Barazi Gjinore 05/L -020.**
- **Ligji për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje 03/L-182, datë 10.08.2010.**
- **Ligji për Inspektoratin Policor të Kosovës, 2008/03/L-036, datë 16.11.2010.**
- **Ligji për Policinë e Kosovës, nr. 04/L-076, 19.03.2012.**
- **Ligji për Prokurorin e Shtetit, nr. 03/L-225, i plotësuar dhe ndryshuar me ligjin nr. 05/L034, datë 30.06.2015 dhe ligjin nr. 06/L-025, datë 19.04.2018.**
- **Ligji për Mbrojtjen nga Diskriminimi, nr. 05/L-021, datë 26.06.2015.**
- **Ligji për Familjen nr. 2004/32, datë 01.09.2006, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin**
- **06/L-077, datë 17.01.2019.**
- **Ligji për Shërbimin Mjekësor Emergjent, nr. 05/L-024, datë 21.11.2016.**
- **Ligji për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, nr. 06/L-082, datë 25.02.2019.**
- **Ligji për kompensimin e viktimave të krimit, nr. 05/L-036, datë 30.06.2015.**
- **Ligji nr. 04/L-218 për parandalimin dhe luftimin e trafikimit me njerëz dhe mbrojtjen e viktimave të trafikimit, datë 04.09.2013.**
- **Ligji nr. 04/L-015 për mbrojtjen e dëshmitarëve, datë 01.09.2011.**

- **Ligji nr. 04/L-172 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.04/L-054 për statusin dhe të drejtat e dëshmorëve, invalidëve, veteranëve, pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, viktimave të dhunës seksuale të luftës, viktimave civile dhe familjarëve të tyre.**
- **Ligji nr. 06/L-084 për mbrojtjen e fëmijës, datë 17.07.2019,**
- **Ligji Nr. 02/L-17 për shërbime sociale dhe familjare, etj.**

Kushtetuta e Republikës së Kosovës, *neni 31 paragrafi 6 definon* se "Ndihma Juridike Falas do t'u mundësohet atyre që nuk kanë mjete të mjaftueshme financiare, nëse një ndihmë e tillë është e domosdoshme, për të siguruar qasje efektive në drejtësi".

Ligji nr.04/L-017 për Ndihmë Juridike Falas - është ligji bazik për fushën e ofrimit të ndihmës juridike falas, i cili përmban edhe dispozita juridike, duke i përcaktuar kompetencat dhe përgjegjësitë e ANJF-së. Ligji bazik rregullon krijimin e një sistemi funksional për Ndihmë Juridike Falas në procedurën Civile, Penale, Administrative dhe Kundërvajtëse, duke siguruar qasjen efektive në drejtësi për qytetarët të cilët nuk kanë mjete të mjaftueshme financiare.

Me anë të Ligjit, parashihet ndihmë juridike falas në tërë territorin e Republikës së Kosovës pa përjashtim, dhe atë në procedurën gjyqësore civile, penale, administrative dhe Kundërvajtëse, lidhur me informatat dhe këshillat juridike rreth procedurave ligjore, përpilimit të shkresave dhe mbështetjes administrative/teknike lidhur me kompletimin e lëndës si dhe me përfaqësimin gjyqësor. Sipas legjislacionit të Kosovës për të qenë përfitues i ndihmës juridike falas duhet të plotësohet **kriteri kualifikues** (ka të bëjë me personat me të drejtë përfitimi ku bëjnë pjesë shtetasit e Republikës së Kosovës me vendbanim në Kosovë, personat me qëndrim të përkohshëm, personat tjerë të përcaktuar me legjislacion apo rregullat e të drejtës ndërkombëtare dhe personat që përfitojnë në bazë të reciprocitetit), **kriteri financiar** (klasifikohet në ndihmë juridike primare dhe u dedikohet personave që janë përfitues të ndihmës sociale dhe personave në situatë të ngjashme me këta të fundit dhe ndihmë juridike sekondare e cila u dedikohet personave me të ardhura familjare më të ulëta se sa të ardhurat mesatare familjare) dhe **kriteri juridik** (specifikat e rastit juridik siç janë vlera reale e kërkesë, fuqia argumentuese e provave dhe mundësia e suksesit të kërkesës). Ligji parasheh edhe ndihmën juridike falas të menjëhershme e cila ofrohet për personat e arrestuar apo ndaluar në polici, pavarësisht nëse janë përmbushur kriteret e parapara me ligj.

Mbrojtja juridike falas u ofrohet të gjitha subjekteve të cilat plotësojnë kriteret e përcaktuara me ligj. Sipas këtij ligji, mbrojtja juridike, ndër të tjera, nënkupton përfaqësimin në procedurën civile, penale, administrative dhe Kundërvajtëse.

Duke qenë se ofrohet ndihma juridike falas në shtrirje territoriale në gjithë Kosovën, ajo mundësohet përmes zyrave Rajonale, zyrave Mobile, nga avokatët dhe organizatat jo-qeveritare partnere të Agjencisë. Procedura për përfitimin e ndihmës juridike falas iniciohet përmes kërkesës bashkë me provat dhe dokumentacionin relevant dhe më pas ajo i nënshtrohet vlerësimit nga zyrtarët të cilët nxjerrin vendim për lejimin ose refuzimin e kërkesës, brenda afatit prej 5 ditëve nga dita e dorëzimit të dokumentacionit të kompletuar. Me vendim po ashtu përcaktohen shërbimet e autorizuara të cilat i komunikohen avokatit mbrojtës. Në rast të refuzimit, parashtruesi i kërkesës ka të drejtën të paraqesë Ankesë në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të vendimit mbi refuzimin, dhe lidhur me ankesën do të vendosë në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të saj nga komisioni i ankesave i ne Kuadër te MD.

3.2. Gjendja aktuale dhe hapat reformues të ANJF-së në aspektin ligjor

Mënyrën e ofrimit të ndihmës juridike falas në Kosovë e rregullon Ligji Nr. 04/L-017 për Ndihmë Juridike Falas, i ndryshuar me ligjet Nr.08/L-035 dhe Ligjin Nr.08/L063. Përgjegjëse për organizimin dhe ofrimin e ndihmës juridike falas është Agjencia për Ndihmë Juridike Falas.

Me datë 13 Mars 2022, ka hyrë në fuqi Ligji Nr. 08/L-035, për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-017, për Ndihmë Juridike Falas si dhe me 20 Shtator 2022 ka hyrë në fuqi Ligji Nr. 08/L-063 - për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjeve që kanë të bëjnë me Racionalizimin dhe Vendosjen e Vijave Llogaridhënëse të Agjencive të Pavarura.

ANJF deri me hyrjen në fuqi të ligjit të lartpërmendur ka pasur të miratuara 8-të (tetë) Rregullore të Brendshme dhe 1 (një) Udhëzim Administrativ, si në vijim:

- Rregullorja ANJF – 01/2021 e Punës së Këshillit për Ndihmë Juridike Falas,
- Rregullorja ANJF - 02/2021 për Procedurat e Punës së Komisionit për Ankesa,
- Rregullorja ANJF - 2013/03 për Përcaktimin e Kualifikimit për Zyrtarët e ZRNJF-së,
- Rregullorja ANJF - 2013/04 për Angazhimin e Avokatëve,
- Rregullorja ANJF - 2013/05 për Përcaktimin e Kritereve për Ofrimin e Ndihmës Juridike Falas nga OJQ-të,

- Rregullorja ANJF-së - 2013/06 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Agjencinë për Ndihmë Juridike Falas,
- Rregullorja nr. 07/2015 e Punës për Agjencinë për Ndihmë Juridike Falas,
- Rregullorja nr. 01/2016 për Menaxhimin Zyrtar dhe Arkivor në Agjencinë për Ndihmë Juridike Falas,
- Udhëzim për Standardet e Raportimit të Brendshëm të Agjencisë për Ndihmë Juridike Falas.
- po ashtu ANJF ka miratuar edhe Planin Strategjik 2021-2025.

Plotësim / ndryshimi i bazës ligjore - Me hyrjen në fuqi të Ligjit Nr. 08/L-063 - për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjeve që kanë të bëjnë me Racionalizimin dhe Vendosjen e Vijave Llogaridhënëse të Agjencive të Pavarura është krijuar mundësia për vlerësim të nevojave për ndryshim të akteve nënligjore të Agjencisë për Ndihmë Juridike Falas, do të bëhet përgatitja dhe hartimi i këtyre akteve:

1. Hartimi i draft Rregullores për caktimin e kritereve për ofrimin e shërbimeve juridike të autorizuara nga organizatat jo- qeveritare. (e nënshkruar nga Ministrja)
2. Hartimi i draft Rregullores për procedurat e ankesave për ndihmë juridike falas. (e nënshkruar nga Ministrja)
3. Hartimi i draft Rregullores për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës ne ANJF, e cila ndodhet në MD për aprovim, pastaj do të bëhet procedimi tutje.
4. Projekt-Rregullore për Organizimin e brendshëm dhe funksionimin e Agjencisë për Ndihmë Juridike falas, e cila ndodhet në MD për aprovim, pastaj do të bëhet procedimi tutje.
5. Udhëzim Administrativ për tarifat dhe kompensimin e shërbimeve të kryera nga Avokatët lidhur me shërbimet e autorizuara të ndihmës juridike falas
6. Udhëzim Administrativ për Procedurat e angazhimit të avokatëve në shërbimet e autorizuara të ndihmës juridike falas
7. Udhëzim administrativ për formën dhe përmbajtjen e formularit për paraqitjen e kërkesës për ndihmë juridike falas

Por, ani pse ky ligj është ndryshuar dhe plotësuar ende konsiderojmë se ka disa mangësi dhe na dalin disa sfida në zbatimin e tij.

3.3 Nevoja për ndryshime dhe plotësime të kornizës ligjore për ndihmë juridike falas

Gjatë zbatimit të ligjit është vërejtur nevoja për veprime korrigjuese në lidhje me Ligjin për Ndihmë Juridike Falas. Më specifikisht, do të mundohemi që nëpërmjet kësaj analize të pasqyrojmë hapat që duhet ndërmarrë për të adresuar sfidat dhe boshllëqet e identifikuara sa i takon zbatimit të Ligjit të ANJF-së.

Gjithashtu, të dhënat nga raportet e zyrtarëve të Zyrave Rajonale dhe Mobile për Ndihmë Juridike Falas, organizatave jo qeveritare, etj. tregojnë se edhe përkundër mandatit të ANJF-së për ofrimin e shërbimeve të Ndihmës Juridike Falas në tërë territorin e Kosovës është vlerësuar se kapacitetet njerëzore e të gjitha zyrave për të ofruar shërbime cilësore në sigurimin e qasjes në drejtësi, vazhdojnë të jenë të kufizuara dhe si të tilla të pamjaftueshme për të siguruar zbatim efikas të Ligjit e sidomos me rritjen e numrit të palëve përfituese me plotësimin e ligjit për kategoritë e veçanta përfituese.

Duke marrë parasysh rëndësinë e jashtëzakonshme që ka LNJF në krijimin e infrastrukturës ligjore dhe institucionale me qëllim të mbrojtjes të të drejtave të qytetarëve, po ashtu, bazuar në sfidat që janë cekur në raportet e ndryshme, si dhe marrë parasysh edhe faktin e detyrimit kushtetues dhe ligjor për të siguruar qasje efektive në drejtësi konsiderojmë se ligji duhet të ndryshohet si në vijim:

Shtrirja e Ndihmës Juridike Falas në tërë territorin e Republikës së Kosovës - Agjencia për Ndihmë Juridike Falas është e përkushtuar të realizoj misionin e saj madhor në ofrimin e shërbimeve të ndihmës juridike falas të gjithë qytetareve të cilët për shkak të mungesës së mjeteve financiare nuk kanë pasur mundësi t'i realizojnë të drejtat e tyre. Me anë të Ligjit parashihet ndihmë juridike falas në gjithë territorin e Republikës së Kosovës pa përjashtim andaj duhet të sigurohet zbatimi i kësaj dispozite të ligjit dhe të bëhet shtrirja e ndihmës juridike falas në tërë territorin e Republikës së Kosovës nëpërmjet hapjes së zyrave mobile.

Unifikimi i ndihmës juridike falas në Kosovë – Konsiderojmë se është nevoja që ky ligj të ndryshohet dhe plotësohet me qëllim të harmonizimit të tij me legjislacionin tjetër në fuqi, por edhe për të saktësuar kompetencat e institucioneve përgjegjëse për zbatimin e këtij ligji si dhe për të saktësuar më tej se Agjencia për Ndihmë Juridike Falas duhet të jetë i vetmi institucion përgjegjës për ofrimin dhe organizimin e Ndihmës Juridike Falas në Kosovë.

Duhet rishikuar Kodin e Procedurës Penale, respektivisht *nenin 56* i cili flet për *Mbrojtjen e detyruar* si dhe *nenin 57 për Mbrojtësin me shpenzime publike kur mbrojtja nuk është e detyruar*, konsiderojmë se kjo kompetencë duhet të kalojë mbi Agjencinë për Ndihmë Juridike Falas ngaqë Ligji për Ndihmën Juridike Falas nuk bën dallimin në

mes të rasteve penale që kërkojnë përfaqësim të detyrueshëm dhe përfaqësim penal kur mbrojtja nuk është e detyruar, e aq më tepër ky ligj nuk llogarit numrin e viteve të burgimit të mundshëm përderisa plotësohen të tri kriteret sipas *nenit 6* të LNJF siç janë: kriteri kualifikues, financiar dhe kriteri juridik apo nëse përfituesi potencial mund të jetë tek kategoritë e veçanta përfituese.

Po ashtu, bazuar në ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që kanë të bëjnë me racionalizimin dhe vendosjen e vijave llogaridhënëse të agjencive të pavarura, organizatat jo-qeveritare ofrojnë shërbime juridike të autorizuara, në bazë të kritereve të përcaktuara nga Ministria përgjegjëse për drejtësi, me propozim të Agjencisë. Ministria e Drejtësisë ka miratuar rregulloren për përcaktimin e kritereve për ofrimin e ndihmës juridike Falas nga organizatat jo qeveritare në partneritet me Agjencinë për ndihmë juridike falas. Qëllimi i kësaj Rregulloreje është përcaktimi i kritereve për ofrimin e shërbimeve juridike falas nga Organizatat Jo - qeveritare në partneritet me Agjencinë për Ndihmë Juridike Falas.

Struktura dhe fuqizimi i Agjencisë – Në Organogramin e miratuar është paraqitur nevoja për punonjës të rinj për t'i përmbushur kërkesat e dispozitave ligjore përkatëse për pozita të caktuara, e të cilat nuk ekzistojnë në ANJF. Për t'i përmbushur kërkesat ligjore dhe për funksionim të mirëfilltë të ANJF-së, pothuajse shumica e zyrtarëve janë të angazhuar me dy ose më shumë punë krahas pozitës për të cilën janë të rekrutuar. ANJF si institucioni i vetëm përgjegjës për ofrimin e ndihmës juridike falas duhet të fuqizohet, po ashtu nevojë elementare është rritja e numrit të burimeve njerëzore dhe financiare për avancimin e sistemit të ndihmës juridike falas në Kosovë.

Sipas rezultateve të kësaj analize dhe të analizave paraprake, rezulton se krahas numrit të përfituesve të ndihmës juridike falas, numri i zyrtarëve në zyrat Rajonale dhe Mobile për ndihmë juridike falas është i mangët andaj për të siguruar një shkallë të lartë efikasiteti dhe funksionim të suksesshëm të shërbimeve juridike falas duhet të rritet numri i zyrtarëve që ofrojnë shërbime të ndihmës juridike falas. Duke parë trendin e rritjes së numrit të përfituesve të ndihmës juridike falas në vitet paraprake rezulton se numri i lëndëve për një zyrtar ligjor në ANJF gjatë vitit 2022 ka qenë rreth 279 lëndë.

Në grafikonin e mëposhtëm janë paraqitur numrat e përfituesve të ndihmës juridike falas, krahasimisht në tre vitet e fundit. Në vitin 2020 ndihma juridike falas është ofruar për 5246 (pesëmijë e dyqind dyzetë e gjashtë) qytetarë, në vitin 2021 kjo ndihmë u është ofruar 4600 (katërmijë e gjashtëqind) qytetarëve, ndërsa në vitin 2022 ndihmë juridike falas kanë përfituar 5861 (pesëmijë e tetëqind e gjashtëdhjetë e një) qytetarë.

Pra, krahasuar me vitin 2020 kemi rritje të numrit të përfituesve të ndihmës juridike falas për 11.72 %, ndërsa krahasuar me vitin 2021 kemi rritje të numrit të përfituesve të ndihmës juridike falas për 27.41 %.

Struktura dhe fuqizimi i Agjencisë – Sensibilizimi i vazhdueshëm i institucioneve dhe organeve të Republikës së Kosovës për rëndësinë që duhet kushtuar këtij institucioni.

Buxheti i pamjaftueshëm - Agjencia për Ndihmë Juridike Falas që nga themelimi si institucion i pavarur, dhe pas ndryshimeve me hyrjen në fuqi të Ligjit Nr. 08/L-035 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-017 për Ndihmë Juridike Falas, si dhe me hyrjen në fuqi të Ligjit Nr. 08/L-063 - për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjeve që kanë të bëjnë me Racionalizimin dhe Vendosjen e Vijave Llogaridhënëse të Agjencive të Pavarura i cili ka për qëllim të bëjë ndryshimin dhe plotësimin e Ligjeve në vijim për racionalizimin dhe vendosjen e vijave llogaridhënëse të Agjencive të Pavarura, nga 21 Shtator 2022 pjesë e Ministrisë së Drejtësisë, burimin kryesor te mjeteve financiare e ka pasur nga buxheti i Republikës së Kosovës, sipas ligjeve për ndarjet buxhetore për Republikën e Kosovës të viteve përkatëse. Meqenëse mundësitë buxhetore kanë qenë të limituara përballë nevojave të mëdha dhe në rritje për të përmbushur obligimin ligjor, Agjencia në vazhdimësi ka arritur që krahas të hyrave publike të sigurojnë përkrahje nga donatoret për të përmbushur, misionin dhe arritjen e objektivave. Sfidat me të mëdha me të cilat është përballur ANJF, janë si pasojë e buxhetit të pamjaftueshëm për arritjen e objektivave në mënyrë të plotë. Po ashtu plotësim ndryshimi i Ligjit për Ndihmë Juridike Falas ka rritur gamën e përfituesve të ndihmës juridike falas, e që njëkohësisht rritet edhe nevoja për buxhet shtesë. Sfidat që na paraqiten në mungesë të buxhetit të mjaftueshëm:

- **Pamundësia e shtrirjes së drejtë dhe të barabartë të Ndihmës Juridike Falas në të gjitha komunat e Republikës së Kosovës, me qëllim të krijimit të qasjes së barabartë në drejtësi për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës,**
- **Avancimi i sistemit të ndihmës juridike falas në drejtim të unifikimit të ndihmës juridike falas në Republikën e Kosovës,**
- **Numri i pamjaftueshëm i stafit,**
- **Sensibilizimi dhe vetëdijesimi i publikut, veçmas i grupeve të interesit, për shërbimet që iu ofrohen nga ANJF-ja,**
- **Sigurimi i mjeteve buxhetore për aftësimin profesional të stafit,**
- **Sigurimi i mjeteve buxhetore për zbatimin e plotësim ndryshimit të Ligjit për Ndihmë Juridike Falas,**

- **Sigurimi i hapësirave të punës për ANJF-në në Prishtinë në objektet publike**, pra, aktivitetin e zhvillojmë në objekt me qera. Lokacioni i zyrës qendrore është: Rr.“ Zenel Salihu ”, Nr.30, Prishtinë. Ndërsa zyrat tjera Rajonale dhe Mobile aktivitetin e zhvillojnë brenda objekteve të institucioneve tjera siç janë: Komunat, Gjykatat, Prokuroritë, Qendrat për punë Sociale etj. Mungesa e zyreve individuale apo edhe hapësirave për ofrim të shërbimeve individuale është raportuar se pengon trajtimin me konfidencialitet të përfituesve që paraqiten në ANJF. Për më tej, është raportuar se në disa raste përfituesit duhet të kalojnë nëpër zyrat e sektorëve tjerë komunal, për të arritur deri te shërbimet e ndihmës juridike falas.

Ligji parasheh edhe **ndihmën juridike falas të menjëhershme** e cila ofrohet për personat e arrestuar apo ndaluar në polici, pavarësisht nëse janë përmbushur kriteret e kërkuara me ligj, përkundër kësaj ANJF operon me vetëm 4 vetura në zyrën qendrore pavarësisht madhësisë së territorit, numrit të punonjësve, numrit të përfituesve, lokacionit të zyrave apo llojit të shërbimeve që ofrojnë. Pothuajse në të gjitha rastet është raportuar se veturat janë janë të stër-vjetëruara, të amortizuara dhe në gjendje të rëndë.

Qasja: Mbi 70% e zyrave Rajonale dhe Mobile raportohet të jenë me lokacion në qendër të qytetit, në disa raste në afërsi të qendrës dhe lehtësisht të identifikueshme për qytetarët. Megjithatë mbi 30% e zyrave kanë raportuar qasje të vështirësuar ose të pamundshme për personat me aftësi të kufizuara dhe personat e moshuar. Disa zyra kanë raportuar se janë të vendosur në katin e dytë, pa qasje në ashensor apo pjerrina të lëvizjes për persona me aftësi të kufizuara. Shtatëmbëdhjetë (17) zyra Rajonale apo Mobile janë përgjigjur se posedojnë ambient të qasshëm për persona me aftësi të kufizuara ndërsa në 10 zyra qasja është e vështirësuar.

Edhe përkundër zgjerimit të bazës së përfituesve për ndihmë juridike falas me Ligjin nr. 08/l-035 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 04/l-017 për ndihmë juridike falas, buxheti i Agjencisë nuk ka ndryshuar. Jemi në fazën e përpilimit të dokumentit lidhur me efektin potencial financiar që mund ta ketë ndryshim plotësimi i ligjit dhe rrjedhimisht rritja potenciale e përfituesve të ndihmës juridike falas. Po ashtu me mbështetjen e donatorit GIZ jemi duke përpiluar një ekspertizë financiare në bazë të së cilës do të pasqyrohen qartë nevojat buxhetore për funksionimin e mirëfilltë të Agjencisë për Ndihmë Juridike Falas.

Kriteret për të qenë përfitues i ndihmës juridike falas dhe kategoritë e veçanta – Sa i përket kritereve të përfituesve në ligj nuk është e specifikuar qartë se si të bëhet zbatimi apo llogaritja e këtyre kritereve, andaj ANJF ka hartuar Udhëzues për

procesimin e rasteve për ndihmë juridike falas në përputhje me Ligjin për Ndihmë Juridike Falas, legjislacionin tjetër në fuqi, aktet nënligjore të ANJF-së si dhe praktikat e mira të identifikuara nga zyrtarët e zyrave rajonale dhe mobile për ndihmë juridike falas me qëllim që të lehtësojë dhe të unifikojë proceset dhe të shërbejë si një udhërrëfyes i dobishëm për zyrtarët për ndihmë juridike falas. Në veçanti, sa i përket vlerësimit të kritereve që duhet plotësuar nga përfituesit e ndihmës juridike falas.

Sa i përket kategorive të veçanta me plotësim ndryshimin e ligjit për Ndihmë Juridike Falas, nuk janë përcaktuar qartë se si zyrtarët e ANJF duhet të vlerësojnë këto kategori dhe cilat mund të konsiderohen dokumente valide që të konsiderohet përfitues një palë bazuar në këtë ligj.

Mënyra e përfaqësimit (angazhimi i avokatëve) - ANJF-ja bashkëpunon në mënyrë të përhershme me Odën e Avokatëve për të ofruar shërbime të Ndihmës Juridike Falas në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe nevojat e qytetarëve.

Bazuar në *nenin 29 të Ligjit për Ndihmë Juridike Falas*, avokatët ofrojnë shërbime juridike të autorizuara në kuadër të Ndihmës Juridike Primare dhe Sekondare.

Oda e Avokatëve të Kosovës sipas ligjit, duhet të përgatit dhe dorëzon tek ANJF-ja Listën e Avokatëve të cilët shprehin gatishmërinë për ofrimin e Ndihmës Juridike Falas.

ANJF lidh kontratë individuale me avokatët e gatshëm për ofrimin e Ndihmës Juridike Falas. Avokatët ofrojnë shërbimet e autorizuara të Ndihmës Juridike Falas sipas tarifës mbi kompensimet e përcaktuara nga ANJF-ja. Zyrat Rajonale dhe Zyrat Mobile për Ndihmë Juridike Falas, për rastet që duhet të përfaqësohen pranë gjykatave dhe organeve të tjera, përfituesve të Ndihmës Juridike Falas i caktojnë avokatë. Shërbimet e autorizuara të përfaqësimit dhe të mbrojtjes në procedurë gjyqësore ofrohen vetëm nga avokatët.

Me qëllim të transparencës për angazhimin e avokatëve, ANJF-ja në mënyrë periodike publikon listën me avokatët e angazhuar në ueb faqen e ANJF-së.

Gjatë vitit 2022 ANJF ka hasur në vështirësi në azhurnimin e listave nga oda e avokatëve edhe përkundër kërkesave tona të vazhdueshme si institucion nuk kemi pranuar lista nga Oda e Avokatëve. Me qëllim të mbarëvajtjes së punës Këshilli ka rekomanduar që lista e avokatëve të shkarkohet nga faqja zyrtare e OAK-së dhe angazhimi i tyre të bëhet duke përzgjedhur avokatët sipas rotacionit.

Shpenzimet e procedurës - Kërkesa për lirim nga shpenzimet e procedurës u lëshohet të gjithë përfituesve të ndihmës juridike falas të cilëve me vendim u është miratuar ndihma juridike falas në rastet kur lënda dorëzohet për shqyrtim në gjykatë. Kërkesa

për lirim nga shpenzimet e procedurës gjyqësore mbetet nën juridiksionin e gjyqtarit të lëndës që ta aprovojë apo ta refuzoj.

Rimbursimi i shpenzimeve – Bazuar në kontratën për angazhimin e avokatit për përfaqësimin e përfituesve të ndihmës juridike falas, sipas nenit 4, avokati obligohet të kërkojë shpenzimet procedurale nga pala kundërshtare, në pajtim me Ligjin nr. 03/L-006 për Procedurën Kontestimore, mjete këto të cilat do të derdhen në buxhetin Republikës së Kosovës.

Përfaqësimi nga zyrtarët deri në vlerën e revizionit - Zyrat rajonale dhe mobile për rastet të cilat duhet t'i përfaqësojnë pranë gjykatave dhe organeve tjera, përfituesit e ndihmës juridike falas, caktojnë avokatin nga lista e azhurnuar prej Odës së Avokatëve. Këto shërbime të autorizuara të përfaqësimit dhe të mbrojtjes në procedura gjyqësore ofrohen vetëm nga avokatët.

Klinikat ligjore - Me ligjin aktual nuk parashikohet funksionimi i klinikave ligjore.

Racionalizimi - Deri në shtator të vitit 2022 Agjencia për Ndihmë Juridike Falas ka funksionuar si e pavarur dhe është mbikëqyrë nga Këshilli për Ndihmë Juridike Falas. Në Shtator të vitit 2022 ka hyrë në fuqi Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që kanë të bëjnë me racionalizimin dhe vendosjen e vijave llogaridhënëse të Agjencive të Pavarura. Ky ligj ka shuar Këshillin për Ndihmë Juridike Falas, me ç 'rast kompetencat e këshillit i kanë kaluar Ministrisë së Drejtësisë. Kështu, Agjencia për Ndihmë Juridike Falas tanimë është bërë pjesë e Ministrisë së Drejtësisë. Ajo çfarë është perceptuar në publik dhe përfaqësuesit e organizatave joqeveritare, është ruajtja e pavarësisë së Agjencisë nga një organ që është politik. [1]

Përveç kësaj, në Ministrinë e Drejtësisë, bën pjesë edhe Avokatura Shtetërore. Për dallim nga Agjencia për Ndihmë Juridike Falas që përfaqëson qytetarët në rastet e tyre kundër shtetit apo rastet e tjera, Avokatura Shtetërore përfaqëson institucionet publike. Të dy këto institucione, tanimë i raportojnë Ministrit të Drejtësisë.

Ligji në fjalë duke e synuar racionalizimin e institucioneve dhe duke e sistemuar Agjencinë për Ndihmë Juridike Falas në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë**, sipas shoqërisë civile** ka ndikuar në mosbesimin e qytetarëve në mbrojtjen e drejtave të tyre ligjore ngaqë, për rastet e njëjta, Ministria e Drejtësisë do të duhet të kujdeset edhe për mbrojtjen e interesit të qytetarëve edhe për mbrojtën e interesit të institucioneve publike. Nën këto rrethana, siguria e qytetarëve, të paktën në perceptimin e tyre, për të kërkuar ndihmë juridike nga Agjencia e cila i raporton ministrit të Drejtësisë, për një rast kundër Avokaturës Shtetërore, konkretisht institucioneve që Avokatura

[1] https://betimiperdrejtesi.com/betimi-per-drejtesi-live-politizimi-kunderkushtetues-i-agjencise-per-ndihme-juridike-falas/

Shtetërore i përfaqëson (p.sh Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, Ministria e Drejtësisë etj) e cila i raporton organit të njëjtë, cenohet seriozisht.

Pra, një numër shumë i lartë i rasteve që janë përfitues të ndihmës juridike falas e që Agjencia i përfaqëson është kundër organeve të ndryshme qeveritare. Sipas statistikave rreth 60 % të rasteve janë kundër institucioneve. Që nga viti 2008 deri me sot, nga gjithsej 59,787 shërbime të ofruara, 35,411 prej tyre kanë të bëjnë me raste të natyrës administrative, kryesisht kundër vendimeve të nxjerra nga organet publike, përfshirë organet qeveritare. Përkatësisht, rreth 60% të totalit të shërbimeve të ndihmë juridike të ofruara nga Agjencia kanë të bëjnë me vendimet e nxjerra nga organet publike. Sipas statistikave të ANJF, gjatë vitit 2021, ka ofruar ndihmë juridike falas në 1,961 raste të cilat kanë qenë të drejtuara kundër vendimeve të institucioneve publike, në vitin 2020 në 2,826 raste, derisa në vitin 2019 ka ofruar ndihmë juridike falas në 2,539 raste të kësaj natyre. Pra, në këto raste, ANJF ka mbrojtur të drejtat e qytetarëve të cilët kanë pretenduar se u janë shkelur të drejtat nga institucionet publike.

Po ashtu, ekziston perceptimi, se kompetencat e ministrit të Drejtësisë për të vendosur si për organin që përfaqëson përfituesit e ndihmës juridike ashtu edhe për organin që përfaqëson institucionet publike, krijon potencial të madh për kurdisje të politikave dhe vendimeve të tjera, njëherit mund të konsiderohet edhe konflikt i interesit.

Çështje tjetër problematike është se për rastin e njejtë Ministria e Drejtësisë duhet të paguaj edhe përfaqësuesin e avokaturës shtetërore edhe për përfaqësuesin e angazhuar nga Agjencia për Ndihmë Juridike Falas nga e njëjta linjë buxhetore, pra në këtë mënyrë krijohen shpenzime/pagesa të dyfishta.

Po ashtu sipas përfaqësuesve të organizatave joqeveritare inkorporimi i kësaj agjencie në Ministrinë e Drejtësisë shkel të drejtat e njeriut dhe është në kundërshtim me Kushtetutën e vendit.

IV. REKOMANDIME

Pas analizës së ligjit, përveç të dhënave të lartëcekura, rekomandimet që duhen konsideruar dhe duhet të përfshihen në ligjin e ri për Ndihmë Juridike Falas, të cilat do të kontribuojnë në zbatimin e Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, *neni 6 (3) (c), e drejta në ndihmë juridike falas është e garantuar në rastet kur i akuzuari nuk ka mjete të mjaftueshme për të paguar për Ndihmë Juridike dhe në rastet kur interesi i drejtësisë këtë e kërkon* si dhe nenit 31 paragrafi 6 të Kushtetutës ku thuhet se "*Ndihma Juridike Falas do t'u mundësohet atyre që nuk kanë mjete të mjaftueshme financiare, nëse një ndihmë e tillë është e domosdoshme, për të siguruar qasje efektive në drejtësi*" si dhe do të avancohej sistemi i ndihmës juridike falas, njëherit do të arrihej edhe integritet adekuat i shërbimeve profesionale dhe të paanshme juridike.

Shtrirja e Ndihmës Juridike Falas në tërë territorin e Republikës së Kosovës – Me ligjin e ri duhet të parashikohet dhe të bëhet shtrirja e ndihmës juridike falas në tërë territorin e Republikës së Kosovës nëpërmjet hapjes së zyrave mobile, gjë që do të konsideronte qasjen efektive në drejtësi për të gjithë. Konsiderojmë se hapja e zyrave mobile për ndihmë juridike falas duhet të bëhet konform Ligjit për Gjykatat - shtatë Zyrat Rajonale dhe zyrat mobile të jenë së paku në komunat ku ka degë të gjykatave themelore.

Unifikimi i ndihmës juridike falas në Kosovë – Konsiderojmë se Agjencia për Ndihmë Juridike Falas duhet të jetë i vetmi institucion që duhet të rregulloj sistemin e Ndihmës Juridike Falas në Kosovë. Ajo duhet të ketë të drejtën për caktimin e *Mbrojtësit me shpenzime publike* pranë organeve gjyqësore kur kërkohet nga Gjykata sipas legjislacionit në fuqi. Sa i përket ofrimit të ndihmës juridike falas nga OJQ-të duhet të merret parasysh në ligjin e ri, rregullorja e miratuar për përcaktimin e kritereve për ofrimin e ndihmës juridike Falas nga organizatat jo qeveritare në partneritet me Agjencinë për ndihmë juridike falas me Nr. 05/2023.

Struktura dhe fuqizimi i Agjencisë – ANJF si institucioni i vetëm përgjegjës për ofrimin e ndihmës juridike falas duhet të fuqizohet, po ashtu nevojë elementare është rritja e numrit të burimeve njerëzore dhe financiare për avancimin e sistemit të ndihmës juridike falas në Kosovë.

Sipas rezultateve të kësaj analize dhe të analizave paraprake, rezulton se krahas numrit të përfituesve të ndihmës juridike falas, numri i zyrtarëve në zyrat Rajonale dhe Mobile për ndihmë juridike falas është i mangët andaj për të siguruar një shkallë të lartë efikasiteti dhe funksionim të suksesshëm të shërbimeve juridike falas duhet të rritet numri i zyrtarëve që ofrojnë shërbime të ndihmës juridike falas. Duke parë

trendin e rritjes së numrit të përfituesve të ndihmës juridike falas në vitet paraprake rezulton se numri i lëndëve për një zyrtar ligjor në ANJF gjatë vitit 2022 ka qenë rreth 279 lëndë.

Në grafikonin e mëposhtëm janë paraqitur numrat e përfituesve të ndihmës juridike falas, krahasimisht në tre vitet e fundit. Në vitin 2020 ndihma juridike falas është ofruar për 5246 (pesëmijë e dyqind dyzetë e gjashtë) qytetarë, në vitin 2021 kjo ndihmë u është ofruar 4600 (katërmijë e gjashtëqind) qytetarëve, ndërsa në vitin 2022 ndihmë juridike falas kanë përfituar 5861 (pesëmijë e tetëqind e gjashtëdhjetë e një) qytetarë. Pra krahasuar me vitin 2020 kemi rritje të numrit të përfituesve të ndihmës juridike falas për 11.72 %, ndërsa krahasuar me vitin 2021 kemi rritje të numrit të përfituesve të ndihmës juridike falas për 27.41 %.



Po ashtu duhet theksuar se ANJF përkundër obligimeve që rrjedhin nga ligjet përkatëse vazhdon të përballet me mungesën e zyrtarëve, pozita të cilat janë të nevojshme për një institucion:

- Zyrtar Ligjor
- Menaxher i personelit;
- Zyrtar çertifikues;
- Zyrtar për marrëdhënie me publikun;
- Zyrtar ekzekutiv;

- Zyrtar administrativ;
- Udhëheqës i Divizionit për monitorimin e shërbimeve të ndihmës juridike falas;
- Udhëheqës i Divizionit për buxhet dhe financa;
- Udhëheqës i Divizionit për shërbime të përgjithshme.

Të gjitha këto pozita të obligueshme për një institucion, ANJF-ja është e detyruar që t'i plotësojë duke i obliguar nëpunësit nga pozitat e tjera që të kryejnë nga dy ose tre punë në të njëjtën kohë.

Përkundër sfidave ANJF qëndron e përkushtuar në shërbim të gjithë atyre që i plotësojnë kriteret e përcaktuara me ligj për t'iu ofruar Ndihma Juridike Falas, veçanërisht duke respektuar parimet e drejtësisë dhe sundimit të ligjit.

Buxheti i pamjaftueshëm - Për Agjencinë për Ndihmë Juridike Falas duhet të bëhet planifikimi i drejte buxhetor duke synuar mbulueshmerinë në tërësi te rasteve sipas procedurave te caktuara gjyqësore për te gjitha kategoritë. Kostimi adekuat i shërbimeve të ndihmës juridike falas. Formula e financimit për shërbime juridike falas duhet të nxjerrë koston për secilin përfitues potencial.

Kriteret për të qenë përfitues i ndihmës juridike falas dhe kategoritë e veçanta –

Duhet të përcaktohen më saktësisht dhe më qartë, tekstualisht p.sh "Të ardhurat e një personi, i cili jeton në një familje, konsiderohen të pamjaftueshme, nëse të ardhurat në total të të gjithë pjesëtarëve të familjes, të pjesëtuara për numrin e anëtarëve të familjes, janë më të ulëta se paga minimale mujore e përcaktuar sipas legjislacionit në fuqi". Nëse do të ishte kështu specifike do të ishte më e lehtë në zbatim.

Sa i përket kategorive të veçanta me plotësim ndryshimin e ligjit për Ndihmë Juridike Falas, nuk janë përcaktuar qartë se si zyrtarët e ANJF duhet të vlerësojnë këto kategori dhe cilat mund të konsiderohen dokumente valide që të konsiderohet përfitues një palë bazuar në këtë ligj.

Mënyra e përfaqësimit (angazhimi i avokatëve) – Duhet të obligohet me ligj bashkëpunimi me Odën e Avokatëve për të ofruar shërbime të Ndihmës Juridike Falas në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe nevojat e qytetarëve.

Oda e Avokatëve të Kosovës duhet të përgatit dhe dorëzon tek ANJF-ja Listën e Avokatëve të cilët shprehin gatishmërinë për ofrimin e Ndihmës Juridike Falas.

Shpenzimet e procedurës - Nga praktikat e përgjithshme kemi hasur në vështirësi për aprovimin e kësaj kërkese për lirimin nga shpenzimet e procedurës, veçanërisht kur bëhet fjalë tek shpenzimet lidhur me përfaqësuesin e përkohshëm, duke marr për

bazë se palët përfituese të ndihmës juridike falas nuk kanë mjete të mjaftueshme financiare dhe kostoja është mjaftë e lartë. Përfituesit e ndihmës Juridike Falas duhet të lirohen edhe nga shpenzimet e procedurës gjyqësore.

Rimbursimi i shpenzimeve –ANJF në vazhdimësi ka hasur në vështirësi lidhur me rimbursimin e këtyre shpenzimeve të procedurës andaj edhe kjo duhet të përcaktohet me ligj se si të rregullohet.

Përfaqësimi nga zyrtarët deri në vlerën e revizionit - Konsiderojmë se zyrtarët e ANJF duhet të kenë të drejtën në përfaqësim duke e ditur se disa nga Organizatat Joqeveritare që ofrojnë ndihmë juridike falas, palët e tyre i përfaqësojnë pranë organeve administrative dhe gjyqësore.

Klinikat ligjore - Me ligjin e ri për Ndihmë Juridike Falas duhet të parashikohet funksionimi i klinikave ligjore.

Racionalizimi – Duhet të ruhet pavarësia e Agjencisë.

Ligji për Ndihmë Juridike Falas është një dokument i cili pësoi ndryshime të caktuara gjatë vitit 2022, disa nga të cilat i vlerësojmë si ngritje cilësore dhe potencim të parimeve të ligjshmërisë, efektivitetit, efikasitetit dhe gjithë përfshirjes.

Por edhe në plotësimin dhe ndryshimin e ligjit NR. 04/L-017 në të cilin janë shtuar kategoritë e veçanta të përfituesve ka një dozë jo reale të zbatimit të mundshëm të tij, andaj konsiderojmë se duhet të ndryshohet neni 10 (A) me qëllim që ndihma juridike falas të ofrohet edhe pa "Vendim" të organit kompetent kur kemi të bëjmë me diskriminim.

Reforma e shërbimeve të ndihmës Juridike Falas, përmes zgjidhjeve të duhura ligjore, do të mundësojë tejkalimin e dobësive dhe mospërputhshmërive të detektuara si një problem thelbësor në funksionimin aktual të shërbimeve të ndihmës juridike falas. Për të siguruar një shkallë të lartë efikasiteti dhe funksionimi të suksesshëm të këtyre shërbimeve, duhet miratuar një Ligj i veçantë në kuadër të të cilit duhet përcaktuar me definim të saktë fushëveprimin, përbërjen, mënyrën e punës, kriteret, kategoritë përfituese vendimmarrjen etj, në përputhje me standardet që janë të domosdoshme në avancimin e sistemit të ndihmës juridike falas në tersi.